



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 136/2024
Prishtinë, më 4.6.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku- Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Mungoi: Abelard Tahiri, anëtar.

E ftuar: Neime Binaku – Isufi, kryetare e Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës (AKRK).

Pjesëmarrës tjerë: Kaltrina Sela, Nafije Osdautaj, Florent Mehmeti, Salihe Gashi- Loku, dhe Selajdin Beqa, AKRK; Salih Hoxha, Bedri Baliu, GP LVV; Ermira Llapashtica, Kuvend; Jeta Huruglica, GP LDK dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 21 dhe 23.5.2024;**
- 3. Formimi i grupeve të punës për shqyrtimin e projektligjeve në procedurë;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës (AKRK) për vitin 2023;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 21 dhe 23.5.2024

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 21 dhe 23.5.2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Formimi i grupeve të punës për shqyrtimin e projektligjeve në procedurë

Kryetari, theksoi në bazë të nenit 43 të Rregullores së Kuvendit, do të formojmë grupet e punës për shqyrtimin e tri projektligjeve, që tashmë kanë kaluar leximin e parë.

Për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, Komisioni nxori si në vijim:

V E N D I M

- 1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, në këtë përbërje: Jeta Statovci, kryesuese, Armend Muja, Driton Hyseni, Valentina Bunjaku- Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë;*
- 2. Shpenzimet e krijuara nga aktivitetet e grupit të punës, mbulohen nga buxheti i komisionit.*

Për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit, Komisioni vendosi si në vijim:

V E N D I M

- 1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit, në këtë përbërje: Driton Hyseni, kryesues, Mimoza Kusari - Lila, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku- Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë;*
- 2. Shpenzimet e krijuara nga aktivitetet e grupit të punës, mbulohen nga buxheti i Komisionit.*

Për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-295 për krypto-asetet, Komisioni vendosi si në vijim:

V E N D I M

- 1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-295 për krypto-asetet, në këtë përbërje: Mimoza Kusari – Lila, kryesuese, Jeta Statovci, Driton Hyseni, Valentina Bunjaku- Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë;*
- 2. Shpenzimet e krijuara nga aktivitetet e grupit të punës, mbulohen nga buxheti i Komisionit.*

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës (AKRK), për vitin 2023

Kryesuesi, tha se në bazë të nenit 26, nënparagrafi 1.13. të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës (AKRK), raporton çdo vit në Kuvendin e Kosovës. Raporti vjetor përshkruan aktivitetet e AKRK-së dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë aktorët profesionistë rreth funksionimit të AKRK-së, duke i siguruar lidhur me transparencën e punës së tij dhe

ndërgjegjësimin e ngritur për kulturën e konkurrencës në Republikën e Kosovës. Nga stafi e keni marrë një memo, me të cilin keni një analizë dhe disa pyetje lidhur me këtë raport vjetor. Për ta prezantuar raportin, ia kaloj fjalën znj. Neime Binaku- Isufi, kryetare e Komisionit për Autoritetin e Konkurrencës, dhe mandej hapim debat.

Neime Binaku- Isufi, kryetare e Komisionit për Autoritetin e Konkurrencës (AKRK), tha se viti 2023 ka qenë një periudhë e rëndësishme dhe e mbushur me sfida për sektorin e konkurrencës në Republikën e Kosovës. Autoriteti i Konkurrencës ka punuar me përkushtim të vazhdueshëm për të identifikuar dhe hetuar raste të shkeljeve të Ligjit të konkurrencës, duke kërkuar gjithmonë të zbatohet ligji në mënyrë të drejtë dhe efektive. Në të njëjtën kohë, jemi kujdesur për të ndërgjegjësuar bizneset dhe konsumatorët për rëndësinë e konkurrencës së lirë në tregun tonë. Këto janë vetëm disa prej sfidave dhe arritjeve tona. Bashkërisht, ne vazhdojmë të punojmë drejt një tregu më të drejtë dhe më konkurrues për të gjithë, duke siguruar që Kosova të ketë një ambient ekonomik tërheqës dhe të qëndrueshëm. Edhe në vitin 2023, kemi vazhduar me rastet e procedurave hetimore të hapura vite më parë dhe gjatë vitit 2023 sfidë ka qenë trajtimi, shqyrtimi dhe vlerësimi i rasteve të hapura në procedura hetimore, zhvillimi i institucionit në aspektin e ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe edukimit të vazhdueshëm me projektin e BE-së (IPA II), i cili ka vazhduar me përkrahje dhe mbështetje të AKRK, deri më 14 shkurt 2024. Sfiduese kanë qenë procedurat e rekrutimit, i stafit menaxherial dhe profesional e po ashtu edhe afati ligjor për hartimin e legjislacionit sekondar në zbatim të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e konkurrencës. Vitin që lamë pas, në kuadër të avokimit, AKRK së bashku me zyrën e projektit të BE-së, ka organizuar konferencën me ç’ rast më 10 tetor 2023 ka themeluar Ditën e Konkurrencës në Kosovë, e cila do të organizohet çdo vit, në vijimësi. Për vitin vijues, AKRK ka hartuar planin e punës dhe Strategjinë e AKRK-së 2024 – 2026, së cilës do të vazhdoj të mbetem thellësisht e përkushtuar, që përmes vendimmarrjes dhe aktiviteteve, të cilat në mënyrë të vazhdueshme e avancojnë më tej kualitetin, efikasitetin, llogaridhënien dhe transparencën, të kontribuoj në zhvillimin e mëtejshëm të shtetit të së drejtës dhe parimeve bazë të ekonomisë të tregut të lirë në Republikën e Kosovës. Mandati i Autoritetit, i cili bazohet në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, mbështetet në tri shtylla kryesore, që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës: abuzimin me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara / kartelet, përqendrimet e ndërmarrjeve, si dhe avokimi. Vendimet e marra në mes të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduara, të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në rregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese, si dhe kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë. Qëllimi i këtij institucioni është që t’i kontribuojë mirëkuptimit të problemit të konkurrencës në treg në të gjitha strukturat e autoriteteve ekzekutive, legjislative e gjyqësore dhe të marrim pjesë në ndryshimet e tyre, si dhe ta informojmë administratën shtetërore, por edhe shtresat e gjëra të qytetarëve, lidhur me fenomenet të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës. Nga konkurrenca përfitojnë të gjithë: konsumatorët, bizneset dhe ekonomia në tërësi. Ajo ofron një ofertë dhe cilësi më të mirë, si dhe çmime më të ulëta të produkteve dhe shërbimeve, e inkurajon inovacionin dhe ndikon në rritjen ekonomike. Andaj, rritja e ndërgjegjësimit përmes promovimit të saj është detyrë e këtij institucioni.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti kryetaren e Bordit të AKRK-së: Cili është fushëveprimi i AKRK-së?

Neime Binaku- Isufi, tha se fushëveprimtaria e AKRK-së është rregullimi i tregut të lirë, Autoriteti i Konkurrencës punën e tij e mbështet në tre shtylla kryesore, siç janë: pozita dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe përqendrimit e kompanive.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se i akuzuari Selaidin Beqa, në nëntor të vitit të kaluar ka rrahur zyrtarin Shemsedin Elezin, të njëjtin në dhjetor të po atij viti e keni emëruar drejtor. Me çfarë baze e keni emëruar drejtor dhe a keni qenë e njoftuar për këtë rast, para se ta emëroni?

Neime Binaku- Isufi, tha se është emëruar sipas dispozitave të Ligjit për zyrtarë publikë dhe është përzgjedhur nga Komisioni vlerësues.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti: A e keni marrë pëlqimin e bordit për këtë emërim?

Neime Binaku – Isufi, u përgjigj, po.

Nafije Osdautaj, anëtare e Komisionit për Autoritetin e Konkurrencës, tha se kryetarja e ka emëruar krye në vete dhe se nuk është konsultuar fare me ne, edhe përkundër faktit që ne kemi insistuar që të pritet komisioni i jashtëm, i cili nuk është formuar. Ne kemi qenë kundër këtij emërimi dhe nuk kemi qenë të njoftuar dhe vetëm kur kemi parë që është emëruar drejtori.

Florent Mehmeti, anëtar i Komisionit për Autoritetin e Konkurrencës, duhet ta dimë se ekziston prezumimi i pafajësisë, kemi dy Ligje, Ligjin për zyrtarët publik dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, ku ligji për zyrtarët publik parasheh edhe heshtjen administrative. Tash këtu nuk e di, Kryetarja le të përgjigjet se si e ka mëndu, si heshtje administrative. Me sa jam në dijeni ka pasur një konkurs të cilët ja kanë nënshtruar kandidatët. Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës e parasheh, kryetarja propozon dhe Komisioni e zgjedh.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti rreth vendosjes së kamerave në ambiente të AKRK-së: A keni marrë miratimin e anëtarëve të bordit dhe kush i kontrollon këto kamera?

Neime Binaku- Isufi, tha se pas incidentit që ka ndodhur në ambientet e punës, ne kemi vendosur që për shkak të sigurisë, të vendosen kamerat, tha se kemi marrë vendim për këtë çështje.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti: A i keni mbyllur zyrtarët në ambientet e zyrave, ka pasur një punonjëse me dializë dhe nuk i ke lejuar për të dalë nën arsyetimin se ka rrjedhje të informacionit.

Neime Binaku- Isufi, tha se ai ka qenë një rast emergjent, që është dashur patjetër të kryejnë punën e tyre organet e hetuesisë.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti: A jeni takuar ju personalisht me kompani të cilat ju i keni hetuar?

Neime Binaku- Isufi, tha se jo, nuk jam takuar.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti: Në konkursin për punësim, sa militantë i keni punësuar? Po ashtu pyeti për Leonora Ujkanin, për të cilën tha se e keni pasur asistente dhe tani e keni emëruar pa përfillur asnjë procedurë në pozitën e inspektores. A ka pasur konkurs për këtë pozitë?

Neime Binaku- Isufi, tha unë nuk jam përgjegjëse për rekrutim. Po ashtu, tha se Leonora Ujkani iu ka nënshtruar konkursit dhe i ka plotësuar të gjitha kriteret.

Pas një debati të tensionuar, u krijua paqartësi në mbledhje.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti për angazhimin e Emrush Ujkanit dhe pjesëmarrjen e tij nëpër vizita zyrtare jashtë vendit me shpenzime të mbuluara nga AKRK: Çka përfaqëson ai dhe a është Leonora Ujkani gruaja e tij, që punon në të njëjtin institucion?

Neime Binaku- Isufi, tha se Emrush Ujkani është i angazhuar si ekspert i jashtëm në AKRK dhe angazhimi i tij është i bazuar në ligj dhe rregullore për udhëtime zyrtare.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti: A ke vendim për emërimin e tij si ekspert i jashtëm?

Neime Binaku- Isufi, tha se e kam angazhuar në bazë të ligjit.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, pyeti: A të ka rekomanduar Bordi i AKRK-së pezullimin e vendimit për përzgjedhjen e drejtorit, i cili është i akuzuar dhe sa anëtarë të bordit janë tërhequr nga ky rekomandim pastaj?

Neime Binaku- Isufi, tha se, po, bordi ka rekomanduar, por për shkak të kohës së shkurtër, nuk kam mundur ta shqyrtoj atë rekomandim, tha se dy nga anëtarët e bordit janë tërhequr nga ky rekomandim.

Florent Mehmeti, tha se tërheqja e nënshkrimeve për rekomandimin në fjalë, ne kemi konsideruar se kjo është një çështje komplet juridiko-administrative dhe nuk kemi dashur të bëhet pjesë për qëllime të tjera politike.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, tha se tërheqja e vendimeve është bërë për shkak të joshjes me lejim të shfrytëzimit të veturave zyrtare, dhe në fund, propozoj që të rekomandohet shkarkimi i këtij bordi.

Florent Mehmeti, tha se me përgjegjësi morale dhe juridike, deklaroj se veturat zyrtare shfrytëzohet vetëm për nevoja të punës dhe assesi për nevoja private.

Salihe Gashi- Loku, anëtare e Komisionit për Autoritetin e Konkurrencës, tha veturat nuk na janë ofruar as nga kryetarja, e as nga drejtori, por na ka mundur rregullorja, e cila është në fuqi.

Kryetari pyeti: A është në harmoni me legjislacionin përkatës miratimi i rregullores për sekrete tregtare, kush është pjesë e grupit që ka punuar në këtë rregullore, kur është miratuar dhe a mund ta kem këtë rregullore?

Florent Mehmeti, tha se po, këtë rregullore mund ta keni. E njëjta është e publikuar edhe në faqen tonë zyrtare, nuk kam njohuri se kush ka punuar në të, jemi në fazën e plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës dhe i njëjti do të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-së.

Kryetari kërkoi informacione me shkrim rreth kësaj rregulloreje, se kush ka qenë pjesë e grupit punues, a është e bazuar në ligj. Ai pyeti rreth procedurave rreth dy institucioneve publike, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ibër-Lepencin.

Në shenjë proteste që iu dha fjala z. Selajdin Beqa, deputetja Valentina Bunjaku- Rexhepi, e lëshoi mbledhjen.

Selajdin Beqa, drejtor i Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, tha se rasti i kontratës së Ibër-Lepencit është i iniciuar nga ZRRE, qysh nga shkurti i vitit 2022. Kurse, rasti i Eurolonës ka të bëjë me një ankand të Ministrisë së Bujqësisë dhe Euroлона nuk ka arritur të fitojë një grant dhe ka hapur rast tek ne. Kur e kemi parë këtë rast, nuk kemi iniciuar rast fare, sepse rregullat e vendosura nga Ministria e Bujqësisë nuk janë plotësuar nga Euroлона.

Pal Lekaj, pyeti rreth angazhimit të Emrush Ujkanit, në cilësinë e ekspertit. Ai tha se i njëjti përfaqëson investitorët evropianë, që është odë ekonomike, në anën tjetër ka të angazhuar bashkëshorten si inspektore në Autoritetin e Konkurrencës. Pra, te ju, a nuk është ky konflikt interesi? Ai pyeti rreth zbritjes së buxhetit për 81.000 euro, pse ka ndodhur kjo? Kur jemi te rekrutimi, keni një punëtor më shumë se sa është paraparë nga buxheti i planifikuar. Keni ngritje të pagave për 29.000 euro. Pse ka ndodhur kjo? Në faqe 6 e tutje të raportit, pasqyrohet gjendja e shqyrtimit të 33 rasteve të përqendrimit të ndërmarrjeve. A mund të konstatojmë se nga përqendrimi i ndërmarrjeve nuk është krijuar ose forcuar pozita dominuese e ndërmarrjeve në dëm të konsumatorëve?

Driton Hyseni, pyeti rreth gjobës prej 1.5 milion, për të cilën u potencua se është gjobitur operatori ekonomik. A është ekzekutuar kjo gjobë dhe cilat kanë qenë shkeljet për të cilat është shqiptuar kjo gjobë? Ai pyeti rreth rastit të vajit, ky rast është iniciuar në mars të vitit 2022, sa kohë duhet që të marr epilog ky rast, ku është problemi, a nuk keni kapacitete apo nuk keni vullnet për të vlerësuar këtë rast?

Selajdin Beqa, tha se akuza ndaj meje ka elemente imagjinare për këtë edhe hetuesia do të thotë fjalën e vet. AKRK ka ndryshuar nga ardhja e këtij bordi të respektuar. Ne kemi hapur raste ndaj kompanive të mëdha dhe AKRK tani ka ndryshuar në punën e përditshme. Në lidhje me angazhimin e ekspertit të jashtëm dhe punësimit të gruas së tij, ajo i është nënshtruar konkursit të rregullt dhe ka qenë njëra ndër kandidatet fituese dhe ka pasur ankesë edhe në Komisionin e Pavarur të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, dhe ky është një proces tërësisht legjitim. Nuk ka pasur e as nuk ka konflikt të interesit me rastin e angazhimit të z. Emrush Ujkani, si ekspert i jashtëm. Ne kemi shfrytëzuar kontaktet e tij në Republikën Çeke, në Bruksel dhe në Gjykatën

Evropiane të Drejtësisë. Nuk kemi një punëtor më shumë, por i 31-ti është eksperti i jashtëm. Sa i përket rritjes së pagave nuk ka rritje, janë shpenzimet e pagave të cilat i parasheh ligji. Te rasti i përqendrimeve, për momentin nuk ka dhe jemi në përcjellje të kompanive të cilat kanë fuqi më shumë se 40% në treg. Ai tha se në lidhje me incidentin për të cilin u përmend, nuk ka pasur rrahje, por ka qenë më shumë eksces dhe nuk ka të bëjë me rrahje, nuk do të duhej të bëhet gjyqi publik, sepse ekziston prezumimi i pafajësisë dhe organet hetuese do të thonë fjalën e tyre.

Driton Hyseni, pyeti: A ka raste kur ju si anëtar të bordit jeni në konflikt të interesit dhe si veprohet në ato raste? Po ashtu, ai kërkoj përgjigje në lidhje me ekzekutimin e gjobës prej 1.5 milion euro dhe rastit të vajit. Sa orë në ditë anëtarët e bordit qëndrojnë në zyrë për të zgjidhur rastet, të cilat i keni për detyrë?

Neime Binaku- Isufi, tha se në lidhje me gjobën 1.5 milion euro ndaj MTS, nuk është ekzekutuar gjoba, sepse është apeluar në gjykatën kompetente. Ajo tha se rastet nuk kanë mundur të trajtohen, sepse nga 5 anëtarë, kanë mbetur 2, kisha probleme me zëvendëskryetaren znj. Kaltrina Sela, e cila kishte konflikt interesi në rastin “Kujtesa” dhe “Devolli” dhe nuk ishte prezent në masën e 1.5 milionëshit ndaj MTS-së, e cila nuk ishte prezente. Jam përballur me sfida dhe me mosrespektim të orarit e punës, ku asnjëra nuk janë të rregullta në punë, për këtë ju kam drejtuar edhe me shkresë.

Kaltrina Sela, anëtare e Komisionit për Autoritetin e Konkurrencës, tha se në rastin e mosprezencës time në mbledhjen kur është shqiptuar gjoba ndaj MTS, kam pasur rast vdekje të babait. Babi ka vdekur të shtunën dhe unë s’kam mundur të marr pjesë në mbledhjen e së hënës. Sa i përket pjesës tjetër, unë kam vetëm një rast të cilin e kam lajmëruar, që për shkak të biznesit të familjes, në të cilin nuk kam asnjë aksion apo pronësi, por kam dërguar shkresë ne Agjencinë e Kundër Korrupsionit dhe kam marrë përgjigje që të mos marr pjesë në shqyrtimet e atij rasti. Vëmendja ndaj institucionit ka qenë çdoherë korrekte, kam shfrytëzuar pushimin e lehonisë, sepse në vitin 2022 kam pasur një lindje, kam marr pjesë në çdo mbledhje, por kryetarja funksionon në atë mënyrë që kontrollon çdo gjë në institucion.

Armend Muja, tha se mënyra se si raportoni është e pazakonshme, ka një problem me ju. Nëse lëshohemi në raport, nga 15 raste hetimore që i keni përshkruar, 12 prej tyre janë mbyllur, sepse nuk ka kushte për fillim të hetimeve, kurse 3 raste janë të viteve të kaluara. Te rasti i vajit, s’ka rezultat, keni raportuar në vitin 2022 se keni evidencë të patjetërsueshme, që ju kanë dhënë arsye për fillim të hetimeve, nga kjo kohë, vetëm për fillim të hetimeve dhe ju kanë dashur një vit e gjysmë. Sa zgjasin hetimet? Dhe nëse është një zgjatje kaq e madhe pa epilog, nuk ka relevancë mandej përfundimi i hetimeve për raste të caktuara. Në rastin e gjobës ndaj MTS-së, kur janë bërë plotësim-ndryshimet e ligjit, ne kemi kërkuar që juve t’iu mundësohet me ligj që të bëhet ekzekutimi i vendimeve të gjobave. Më duhet një sqarim rreth këtij rasti. Kur keni ardhur në bord, keni ardhur me premtime të mëdha, por diçka nuk po ecë, premtimet e juaja vazhdimisht janë të njëjta, por nuk keni rezultat.

Pal Lekaj, tha se lidhur me angazhimin e ekspertit të jashtëm, z. Emrush Ujkani, nuk kam asgjë kundër që të angazhohen ekspertë, por jam kundër që eksperti të luajë rolin e ambasadorit, sepse ne kemi ambasadat dhe nëse keni vështirësi me shtetin ku shkoni, mund të shfrytëzoni ambasadat dhe jo eksperti të luajë rolin e ambasadorit. Kërkoj me shkrim nga e juaja zyra ligjore, që

angazhimi i ekspertit Emrush Ujkani, nuk paraqet konflikt interesi, ku i njëjti ka të avancuar bashkëshorten në të njëjtin institucion.

Jeta Statovci, pyeti: A mban aktualisht z. Emrush Ujkani pozitën e drejtorit të Këshillit të Investitorëve Evropianë, sepse të mbrosh interesat e bizneseve dhe në anën tjetër të kujdesesh që ato të mos bëhen bashkë, pak a shumë është problem.

Armend Muja, kërkoi zyrtarisht që të krijohet distancë nga Selajdin Beqa, i cili të mos përgjigjet në pyetjet që nuk i bëhen.

Kryetari kërkoi që edhe në kohën e parashtrimit të pyetjes edhe kur të kemi përgjigje, të jemi të informuar zyrtarisht si Komision.

Pas debatit, kryetari konstatoi, se presim raportet me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Financa Publike, mandej e procedojmë në seancë rezolutën, siç parashihet me ligj dhe rregullore.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit